



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2021

Raport nga mbledhja e IV-të e KKSB për vitin 2021

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut **z. Besim Ilazi** me këtë rend dite:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut
- 3.Trajtimi i ambientit dhe menaxhimi i mbeturinave gjatë stinës së verës
- 4.Përgatitja për sfidat eventuale gjatë sezonit veror(zjarret , trafiku i automjeteve...)
- 5.Të ndryshme

Në këtë takim u diskutua situata e përgjithshme e sigurisë në Komunë në periudhën në mes dy takimeve dhe kanë marrë pjesë të gjithë akterët e sigurisë që janë të përcaktuar me **udhëzim administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL** për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi .

Në këtë takim katër anëtarë të këtij këshilli janë me mëditje prej **50 EURO** dhe kompenzimi i tyre bëhet me pjesmarrjen e tyre në këto takime.

Prezencën këta anëtarë e arsyetojnë me nënshkrim në listën e pjesmarrësve në mbledhjet e KKSB-së

Këtij raporti ia bashkangjesim edhe **listën e pjesmarrësve** ku për kompenzim janë:

Fidaïm Fazliu Jashar Selimi , Remzi Reka dhe Shemsedin Abazi .

Kompenzimi bëhet duke u bazuar në **Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB -03/2012 MAPL** për KKSB-të, neni 18 , Vendimin e Kuvendit Komunal për themelimin e KKSB-së si dhe në **Ligjin Nr.03/L-048**

Kaçanik 13.07.2021

Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2021



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i III-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021

Më 19.05.2021

Në takim prezantuan:

Ylber Bajra, nënkryetar i Komunës

Skender Neziri, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Përfaqësuesi i FSK-së

Fadil Guri-Zyra për Komunitete dhe Kthim

Vedat Dema, Zyra për Barazi Gjinore

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Ramadush Osmani, Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencia

Remzi Reka, OMM, „Gjethi”

Jashar Selimi, Këshilli i Prindërve

Fidaim Fazliu, Bashkësia Islame

Zahir Doda, Drejtor i DAK

Me arsyetim mungoi: **Lirije Luta**

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës së Kaçanikut **z. Ylber Bajra** i cili prezantoi pikat e rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut,
3. Inicimi dhe përzgjedhja për realizim i një projekti të sigurisë
4. Të ndryshme.

1.Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar

-Proces verbali u miratua nga të gjithë të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

-Rreth pikës së dytë të rendit të ditës togër Skender Neziri tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe ndërmjet dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile me përjashtim të disa rasteve që vlen të cekën . Në fshatin Doganaj në një kompani ka shpërthyer kalldaja e ftohjes ku një person është lënduar dhe dëmet janë të mëdha .Rreth kësaj ngjarje janë duke u marrë ekipet e specializuara dhe lënda është në procedurë. Gjatë kësaj periudhe është konfiskuar një armë zjarri , ndërsa angazhimi ynë ka qenë edhe në mbrojtjen e pyjeve ku një patrullë e policisë rregullisht patrullon për rreth linjës së parkut nacional dhe gjatë patrullimeve është konfiskuar një masë drusore dhe tri automjete ndërsa lëndët janë proceduar në gjykatë. Jemi në implementim të disa planeve operative , ku si prioritet i kemi dhënë inspektimit të lokaleve rreth respektimit të masave anti-COVID të cilën jemi duke e bërë në bashkëpunim me inspektorët lokal dhe qendrorë. Nga data 22 Mars njësi i hetimeve është në implementim të planit operativ për parandalimin e dukurisë së vjedhjeve të rënda , ku 7 zyrtarë policorë operojnë me veshje civile me qëllim të efikasitetit në kryerjen e punëve të tyre ditore. Gjithsejtë kemi pasur 23 raste penale :

vjedhje e një veture ku personi që ka kryer këtë vepër është kapur dhe është në paraburgim , 6 vjedhje nga të cilat dy të rënda , dëmtim prone 4 raste , dhunë në familje tri raste , vetëvrasje në tentativë dy raste , sulm- një rast , kanosje –një rast , posedim i lëndëve narkotike-një rast dhe një rast vetëvrasje në litarë. Krahasuar me periudhën e njetë të vitit të kaluar numri i vjedhjeve ka rënë falë planit operativ që ka pasur sukses.

Fadil Guri: u tha nga togeri se një patrullë e policisë patrullon vijën nga fshati Doganaj deri te parku nacional dhe është mirë që e kryejnë këtë punë por që rezultate nuk po ka , ngase dita ditës pyjet janë duke u shkatërruar dhe pasojat do ti kemi në të ardhmen me mungesë uji të pijshëm Transporti i masës drusore po bëhet me disa automjete pa regjistrim dhe nga disa persona që janë të njohur nga qytetarët . Institucionet përkatëse që merren me mbrojtjen e pyjeve kanë dështuar në këtë aspekt . Dëmtuesit e pyjeve aktivitetin e tyre e kryejnë pas mesnatës dhe patrullimet ditën nuk kanë efikasitet.

Skender Neziraj: patrullimet kryhen në tri ndërrime, por që po kemi mungesa të automjeteve në kryerjen e detyrave tona . Kompetencat i kemi të kufizuara sa i përket kësaj dukurie ngase ligji e thot që vepra duhet të zihet në vendin e ngjarjes, ndërsa sa i përket transportit të masës drusore nga dëmtuesit e pyjeve është një vepër më e lehtë.

Nënkryetari: dëmtimi i pyjeve është një temë që është diskutuar shumë shpesh, duke i përfshi të gjithë akterët , por që nuk ka pasur ndonjë efekt .Jemi duke u përpjekur që ta kemi një kontakt me Ministrinë përgjegjëse për ruajtjen e pyjeve, ngase pyjet janë duke u shkatërruar e pasojat bien tek ne.

Fadil Guri: me centralizimin e disa kompetencave nga niveli qendrorë, iu kanë marrë kompetencat komunave, duke krijuar agjencione të ndryshme të cilat nuk janë serioze në punën e tyre . Përpara me një institucion siç ishte ekonomia pyjore situata është menaxhuar shumë më mirë.

Remzi Reka:si organizatë për mbrojtjen e mjedisit shumë më herët jemi marrë me këtë problematikë , por që dyshimi ynë është se rojet e pyjeve po bashkëpunojnë me prerësit ilegal të pyjeve .Ne në pjesën e parkut nacional kemi vendosur disa shenja vetëdijuese , shenja për ndalim qarkullim të mjeteve motoristike në pjesën mbi male të Lubotenit, por që këto shenja nuk po përfillen . Dëmtimet e mëdha të pyjeve janë duke ndodhur edhe nga ana tjetër e maleve ku në mënyrë të organizuar dëmtuesit e pyjeve po e shkatërrojnë edhe atë bukuri natyrore që ka mbetë . Ne si këshill për siguri duhet të interesohemi në prokurori për ato pak lëndë që kan se a janë trajtuar dhe çfarë masa janë ndërmarrë për kryerësit e veprave . Propozoj që të thirret edhe një konferencë për media dhe të bëjmë diçka që këtë dukuri ta ndalojmë .

Nënkryetari: Ne si institucion komunal kemi ngritë zërin për çdo dukuri negative por që sistemi i drejtësisë nuk është ka e bënë punën si duhet.

Jashar Selimi: personat që merren me dukurinë e prerjes ilegale të pyjeve janë të njohur si nga policia e poashtu edhe nga sistemi i drejtësisë .Para ca ditëve më ka bërë përshtypje një aktivitet i motociklistëve që pos zhurmës së krijuar ata

kanë paraqitë rrezikshmëri edhe për qytetarët, dhe çka është më keq ata ishin nën përcjelljen e policisë .

Skender Neziri: lidhur me aktivitetin e motociklistëve ne vetëm kemi zbatuar urdhërat e regjionit ngase ata me kohë kanë bërë njoftimin dhe i kanë zbatuar procedurat për mbajtjen e këtij aktiviteti .

Fidaïm Fazliu: tema e dëmtimit të pyjeve është përmendë në çdo takim dhe është brengosëse vetëdija e ulët si nga institucionet që kujdesen për pyje e poashtu edhe nga qytetarët për të parandaluar këtë dukuri . Brengosëse është shtimi i rasteve të dhunës në familje, dhe po më intereson se si janë procedurat e trajtimit të kësaj dukurie si . Gjithashtu më intereson të dijë nga Drejtori i Arsimit rreth sigurisë së përgjithshme nëpër shkolla .

Skender Neziri: rastet e tentim vetëvrasjeve ndodhin për shkak të situatave të ndryshme siq është gjendja ekonomike, kohëve të fundit edhe situata me pandeminë si dhe për shumë arsye tjera . Në rastet e dhunës në familje, ne me të marrë njoftimin se ka ndodhë një rast, shkojmë në vend ngjarje dhe njoftojmë organet kompetente për trajtim dhe më pastaj fillon rehabilitimi i viktimës në forma të ndryshme . Niveli qendrorë i ka dhënë prioritet trajtimit të kësaj dukurie, dhe ne si polici reagojmë menjëher pasi të marrim informacionin përmes dy zyrtarëve policorë që merren me dhunën në familje . Rastet procedohen në gjykatë dhe gjykata i kualifikon për trajtim të mëtutjeshëm .

Zahir Doda: gjendja e sigurisë nëpër shkolla në përgjithësi është e mirë falë edhe bashkëpunimit të mirë që kemi me policinë . Brengosëse është mosinteresi i prindërve për fëmijët e tyre si dhe mosgatishmëria e tyre për të bashkëpunuar . Kohëve të fundit është duke na u përcjellë një dukuri e ikjes masive të nxënësve të shkollave të mesme e sidomos në orët e fundit të orarit mësimorë .

Fatmir Qaka : janë disa çështje problematike që janë ngritur që nga fillimi i punës së KKSBB por nuk kemi arritur ti zgjedhim ngase janë kompetenca të nivelit qendrorë . Duhet që të mirremi seriozisht dhe përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit me nivelin qendrorë këto problematika të kenë një zgjidhje . Një shqetësim që dua të ngrisë është situata me pandeminë .

Më intereson të dijë se a janë ende në fuqi masat ndaj pandemisë, ngase nga ajo që po shihet këto masa nuk janë duke u përmbajtur nga qytetarët . Rrugët janë të mbushura me turma njerëzish , pa maska , pa distancë edhe jashtë orarit të lëvizjes .

FSK- dukuria e dëmtimit të pyjeve është aktuale në tërë Kosovën, por që duhet të krijojmë një TASK-FORC efektive në parandalimin e kësaj dukurie . Më ka pëlqyer ideja e një pjesëmarrësi anëtarë i KKSBB nga një komunë tjetër për përdorimin e dronëve me qëllim të efikasitetit të institucioneve në përcjelljen e atyre që dëmtojnë pyjet . Ne si FSK krahas angazhime të zakonshme që kemi ,

jemi duke zhvilluar edhe trajnime të ndryshme me nxënës të shkollave të mesme me tema të ndryshme si : „Dhënia e ndihmës së parë”, „Orientimi në natyrë e tema tjera që janë në dobi të të rinjëve . Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë në këtë drejtim .

Nënkryetari: FSK është institucion më i vlerësuar dhe ju përgëzoj që krahas obligimeve të zakonshme që keni , ju ofroni edhe aktivitete të tjera për të rinjë . Besoj se do të kemi bashkëpunim në implementim të projekteve të ndryshme që janë në dobi të shoqërisë tonë .

Skender Neziri: sa i përket pyetjes rreth asaj se a janë ende në fuqi masat anti –COVID , këto masa janë ende në fuqi dhe ne ende i zbatojmë këto masa në bazë të planit operativ që kemi . Numri i rasteve është e vërtet që ka rënë por që masat janë ende në fuqi .

3. Inicimi dhe përzgjedhja për realizim i një projekti të sigurisë

Nënkryetari: është detyrë e drejtorive që nga rekomandimet e nxjerrura rreth problematikave që dalin në teren me projekte të ndryshme të sanojnë çdo dukuri që cenon sigurinë qytetare .

Remzi Reka: propozoj që të formohet një grup nga ky këshill së bashku me zyrtarë komunal dhe të dalim në teren për të hulumtuar vende ku duhet të intervenohet dhe të veprojmë menjëherë .Besoj se ka vende të mjaftueshme ku duhet të intervenohet por që ne duhet të përcaktohem në prioritete .

4.Të ndryshme

Në pikën e fundit të rendit të ditës u bisedua rreth inkorporimit të disa aktiviteteve në planin e punës së KKSB , të propozuara në një takim të përbashkët që kemi pasur me organizatën „Sundimi i Demokracisë në Kosovë”. Këto aktivitete ndërlidhen me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe është mirë të sensibilizohet shoqëria në parandalim

Të gjithë u pajtuan që këto aktivitete të inkorporohen në planin e punës por pa e ndryshuar këtë plan duke siguruar hapësirë dhe pjesëmarrës si në panel e poashtu edhe audiencë .


REKOMANDIMET:

1. Përkushtim më i madh i institucioneve në mbrojtjen e pyjeve
2. Angazhim më i madh i institucioneve për siguri në parandalimin e dhunës në familje
3. Të gjinden forma bashkëpunimi me nivelin qendrorë në parandalimin e dukurive negative .
4. Të hulumtohet dhe intervenohet në vendet që cenojnë sigurinë qytetare
5. Të angazhohemi në implementimin dhe realizimin e aktiviteteve në vetëdijesimin e të rinjëve në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm

Pas këtyre diskutimeve Nënkyetari mbylli takimin për tu takuar në terminin e radhës .


Kryesuesi: Nënkyetari i Komunës

z. Ylber Bajra



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka



Lista e pjesmarrjes në mbledhjen e KKSBB-së më datë: 13 .07.2021

Nga kjo listë për pagesë janë:

1.Remzi Reka ,2.Shemsedin Abazi,3.Fidaim Fazliu,4.Jashar Selimi

Vërejtje:pagesën e arsyeton vetëm pjesmarrja në mbledhje që e dëshmon duke nënshkruar prezencën

Emri e Mbiemri	Institucioni (organizata)	Nr.i tel.	E-mail	Nënshkrimi
Fatmir Reka	EUSB	044-346-157	fatmirreka@hotmail.com	[Signature]
ARMEND BIKLIQI	FSK	049 301 617	Armen-d.Biklizi@PRZ-RLS.ORG	[Signature]
SHENSEDIN ABAZI	KLSP	044-264-685	shensedinabazi@live.com	[Signature]
JASHAR SELIMI	K.ESHILLI IIPRINDOR	064/164791	jashar.selimi@live.com	[Signature]
Edmond Selimi	JSHP	044/44-34		[Signature]
Zahir Doda	DRA	044/225351	zahir.doda@kshgju.net	[Signature]
FASER JAH	P.K. KASABIE	044 543 755	faser.jah@kshgju.net	[Signature]
Fidaim Fazliu	Kb1	044/887-455	Fidaim.fazliu@kshgju.net	[Signature]
Remzi Reka	Gjetit	045537873		[Signature]
Lirije Lita	Komiteti për R.	044-824768	liriaz22@live.com	[Signature]
BESIR ILAZ	KOMITETI	044 116-133		[Signature]

Vërtetoi: Kryetari i Komunës

Besim Ilazi

